



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština – Municipality of Prishtina**



## **EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes urgjente të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e mbajtur më 4.06. 2015,  
e cila filloi në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci (LDK), Sami Hamiti, shef i GP-së (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Sokol Krasniqi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Bekim Gashi (LDK), Naime Osmani (LDK), Vjollca Dibra – Ibrahimimi (LDK), Besa Rafuna (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Merita Surkishi (LDK), Flamur Shala (LDK), Abit Kastrati (LDK), Shiqeri Spahiu (LDK), Sylejman Pireva (LVV), Genc Sherifi (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Hatixhe Latifi – Pupovci (LVV), Bardha Dida – Rogova (LVV), Qëndron Kastrati, shef i GP-së (LVV), Ylli Hoxha, (LVV), Kreshnik Ahmeti (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Lirijeta Rexhepi (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Blerand Stavileci (PDK), Laura Zherka (PDK), Remzi Pacolli (AKR), Mirlinda Sopi (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Imer Rusinovci, shef i GP-së (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Abetare Fazliu (LB), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF) dhe Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik (GIS).

**Munguan:** Shaip Shabani (PDK), Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik (KDTP), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (LB) dhe Islam Pacolli, shef i GP-së (AKR),

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues dhe propozoi këtë

## **R E N D I T E:**

### **1. Propozimvendimi për rishikimin e buxhetit për vitin 2015.**

Lidhur me Propozimvendimin për rishikimin e buxhetit për vitin 2015, **kryesuesi** hapi diskutimin.

Faqe 1 nga 2

**Dardan Sejdiu**, nënkryetar, i njoftoi të pranishmit rreth propozimvendimit për rishikimin e buxhetit për vitin 2015, duke shtuar se në bazë të instruksioneve nga Ministria e Financave dhe në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga ky ligj, Komuna e Prishtinës ka bërë rishikime të nevojshme në buxhetin e saj për vitin 2015.

Buxheti i riorientuar në rishikim është 3.549.000 €, apo rreth 6% e buxhetit të përgjithshëm të Komunës së Prishtinës.

**Visar Berisha**, drejtori i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, në pika të shkurtëra i njoftoi të pranishmit duke theksuar se buxheti i propozuar për riorientim është 3,549,000 €. Këto mjete janë marrë nga programet dhe vija buxhetore e disa drejtorive dhe janë orientuar në drejtoritë e tjera për realizimin e projekteve kapitale publike.

**Hysen Durmishi**, drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale, tha se janë dy linja buxhetore që lëvizin, të cilat janë rruga mbi lumin Mat, ku për shkak të kolektorit është ndryshuar projekti dhe 300.000 € të tjera janë hequr nga projekti i rrugës të rrethrotullimi në lagjen "Lakërishta" deri në lagjen "Arbëria". Arsyeja pse hiqen këto mjete është se kontrata për ndërtimin e kolektorit mbi lumin Mat është nënshkruar në nëntor të vitit të kaluar, dhe nuk kemi arritur ende që të fillojmë me punime për shkak të disa problemeve pronësore, të cilat janë në përfundim për t'i zgjidhur.

**Sami Hamiti**, shef i GP të LDK-së, tha se pas një analize të mirëfilltë të këtij propozimvendimi, GP i LDK-së nuk do të marrë pjesë në votim për dokumentin.

**Qëndron Kastrati**, shef i GP të LVV-së, u shpreh në përkrahje të rishikimit të buxhetit. Ai tha se me këtë rishikim do të ketë projekte që janë shumë të rëndësishme dhe në interes të qytetarëve.

**Lirak Çelaj**, shef i GP të PDK-së, theksoi se duke pasur parasysh se kur është miratuar buxheti, këtu në fillim kanë qenë disa prej pikave të cilat janë propaganduar si pika më të rëndësishme të buxhetit, si vizioni i Kryetarit të Komunës për zhvillimin e qytetit, dhe tash shihet se shumë prej këtyre pikave në buxhet janë tërhequr. Si GP këtë propozimvendim nuk do ta votojmë dhe nuk shoh ndonjë arsye që pas komenteve të qëndrojmë më tutje në mbledhje.

Për këtë propozimvendim diskutuan edhe Remzi Pacolli, në emër të GP të AKR-së,

Imer Rusinovci, shef i GP të AAK-së, Feti Mehdiu, shef i GP të PD-së, Abetare Fazliu, në emër të GP të LB-së, Nenad Miladinoviç, përfaqësues i subjektit politik GIS, Muhamet Selmani, Ajnishahe Azemi, Shefki Gashi, Shemsi Veseli, Blerand Stavileci, Arben Vitia, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Dardan Sejdiu, nënkryetar, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

*Para se të hedhej në votim Propozimvendimi për rishikimin e buxhetit për vitin 2015, GP i PDK-së e lëshoi mbledhjen.*

**Kryesuesi konstatoi se me nëntëmbëdhjetë (19) vota për dhe pesëmbëdhjetë (15) abstenime, ( Halim Halimi, Hazir Borovci, Sami Hamiti, Agim Gashi, Shefki Gashi, Mustafë Krasniqi, Shaip Hajrizi, Abit Kastrati, Sokol Krasniqi, Bekim Gashi, Vjollca Dibra-Ibrahimi, Hasime Krasniqi, Flamur Shala, Shiqeri Spahiu dhe Besa Rafuna), u miratua Vendimi për rishikimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2015.**

**Mbledhja mbaroi në orën 15:15.**

**Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit  
Halim Halimi, jur. i dipl.**

Faqe 2 nga 2